



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**  
**NJOFTIM PËR MEDIA**

Kreu i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Alfred Balla ka zhvilluar gjatë ditës së sotme një takim zyrtar me Kryetaren e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami.

Takimi i dy titullarëve të Këshillave që drejtojnë sistemin e prokurorisë dhe atë të gjyqësorit, hap edhe siparin e takimeve zyrtare të kreut të ri të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Alfred Balla.

Në fokus të këtij takimi ishte bashkëpunimi insititucional mes këtyre dy organeve qeverisëse.

Kreu i KLP-së, shprehu vullnetin dhe impenjimin e tij personal dhe të gjithë Këshillit, për të zhvilluar më tej ndërveprimin mes të dy Këshillave, duke vënë theksin tek bashkëpunimi në kuadër të hartimit të akteve nënligjore, procedimet e përbashkëta disiplinore si dhe mbledhjet e përbëshkëta që zhvillojnë KLP dhe KLGJ.